Kronikë

Kamëz/ U kthye para 1 jave nga Anglia, 70 vjeçari vret me katër plumba fqinjin për kanalin e ujërave të zeza! Plagos tjetrin! Report Tv sjell pamje (EMRAT-VIDEO)

Një 70 vjeçar i kthyer një javë më parë nga Anglia vrau me armë zjarri fqinjin e tij 55 vjeçar si dhe plagosi fqinjin tjetër, në rrugën "Fatos Shupi" në Laknas. Autori dhe dy fqinjët janë konflikuar për kanalizimin e ujërave të zeza.

- 4 plumba ndaj viktimës, i plagosuri u qëllua në bark e këmbë! Autori bëri rezistencë, hodhi pistoletën në bahçe
- Njërin fqinj e vrau tjetrin e plagosi, del fotoja e autorit
- 'E vrava për punë kanali', çfarë tha autori pas krimit në Laknas
- Ky është 55 vjeçari që u vra nga fqinji pas sherrit për kanalizimin e ujërave të zeza
- Zbardhet dinamika e vrasjes! Autori kërkoi të bënte lidhjen me kanalin e ujërave të zeza, fqinjët s'pranuan
- VIDEO/ U vra pas sherrit për kanalizimin e ujërave të zeza, viktima ndërroi jetë në derë të autorit
- Shefi i komisariatit: Autori u arrestua në banesë, armën e kishte pa leje! I plagosuri jashtë rrezikut
- Vrasja në Laknas të Tiranës, ja çfarë thotë policia

Redaksia
30 Nëntor, 14:58 | **Përditesimi: 30 Nëntor, 20:01**

Share

KAMËZ- Një person u vra me armë zjarri dhe një tjetër ka mbetur i plagosur pasditen e sotme (30 nëntor) pas një konflikti mes komshinjve në Laknas për kanalin e ujërave të zeza.

70 vjeçari Maliq Marku me origjinë nga Dibra vrau me pistoletë fqinjin e tij 55 vjeçar si dhe plagosi fqinjin tjetër, në rrugën "Fatos Shupi". Report TV mëson se viktima është Shefqet Hasa, i plagosur mbeti Besim Keça, të dy nga Hasi. Ky i fundit ndodhet në spitalin e Traumës në kryeqytet jashtë rrezikut për jetën.

LEXO EDHE:
GOLAT/ Ballkani humbet 0-1 me Plzen, Ilir Daja kthehet në 'Air Albania' pas 708 ditësh! Ernest Muçi shënon në Conference League

Burime nga grupi hetimor bëjnë me dije për Report Tv se ngjarja e rëndë ka ardhur pas një konflikti për shkak të një kanali të ujërave të zeza që ndodhet në rrugën "Fatos Shupi" ku dhe banojnë tre fqinjët.

Si ndodhi vrasja

Disa kohë më parë, vetë banorët e rrugës kanë mbledhur para për ndërtimin e kanalit të ujërave të zeza, por Maliq Marku nuk ka paguar ngaqë ka qenë jashtë shtetit dhe nuk i është dashur. Gazetari Sokol Dema raporton se pasi është kthyer një javë më parë nga Anglia, Maliq Marku ka shkuar tek ujësjellësi për të lidhur edhe banesën e tij me kanalin e ujërave të zeza. Ujësjellësi ka bërë piketimin, ndërsa 2 fqinjët kanë shkuar sot për t'i thënë që nuk do ta ndërtonte. Në gjaknxehtësi e sipër, pas debatit mes tyre, 70 vjeçari ka marrë pistoletën në banesë dhe ka qëlluar duke lënë të vdekur në derë të shtëpisë së tij njërin prej fqinjëve.

Shefqet Hasa i cili ndërroi jetë ka marrë katër plumba, ndërsa 2 plumba, 1 në bark e 1 në këmbë i plagosuri. Në momentin e të shtënave, në afërsi të lagjes ka qenë polici i zonës i cili pasi ka dëgjuar krismat është afruar dhe ka gjetur personin e plagosur duke vrapuar, të cilin e ka marrë me makinë. Më tutje ka gjetur të vdekur Shefqet Hasën. Pas krimit autori Maliq Marku ka hyrë në banesë por kur kanë shkuar efektivët për ta arrestuar fillimisht ka bërë rezistencë për t'u dorëzuar, por pas negociatave ka hedhur armën në bahçe dhe më pas i kanë vënë prangat.

Lajmi në përditësim...

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Autori Maliq Marku dhe viktima Shefqet Hasa

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 18:31

Njërin fqinj e vrau tjetrin e plagosi, del fotoja e autorit të krimit në Laknas

Ky është 70 vjeçari Maliq Marku që vrau me armë zjarri fqinjin e tij 55 vjeçar Shefqet Hasa, si dhe plagosi fqinjin tjetër, në rrugën "Fatos Shupi" në Laknas pas një konflikti për kanalizimin e ujërave të zeza.

B.K/Shqiptarja.com

Share

Ora 17:01

'E vrava për punë kanali', çfarë tha autori pas krimit në Laknas

"E vrava për punë kanali". Kështu ka thënë në deklarimet e para 70 vjeçari Maliq Marku pasi ka vrarë fqinnjin e tij Shefqet Hasa dhe ka plagosur Besim Keçën pas sherrit për kanalin e ujërave të zeza në Laknas të bashkisë Kamëz.

B.K/Shqiptarja.com

Share

Ora 16:48

Vrasja në Laknas, viktima u qëllua me 4 plumba, i plagosuri me plumb në bark e këmbë! Autori bëri rezistencë! Para arrestimit, hodhi pistoletën në bahçe



Detaje të reja janë zbardhur nga ngjarja e rëndë me një të vrarë dhe një të plagosur në Laknas. 4 plumba ka marrë viktima Shefqet Hasa, ndërsa 2 plumba, 1 në bark e 1 në këmbë i plagosuri Besim Keça. Në momentin e të shtënave, në afërsi të zonës ka qenë polici i zonës, i cili e ka dëgjuar dhe më pas është afruar dhe ka gjetur personin e plagosur duke vrapuar, e ka vendosur në makinë.

Më tutje ka gjetur të vdekur Shefqet Hasën. Ka hyrë në banesë dhe brenda autori Maliq Marku fillimisht ka bërë rezistencë për t'u dorëzuar, por pas negociatave ka hedhur armën në bahçe dhe më pas i kanë vënë prangat. Në deklarimet e para ka thënë se e vrava për punë kanali.

B.V/Shqiptarja.com

Share

Ora 16:42

Dinamika e vrasjes në Laknas! Fqinjët s'pranuan të lidhte banesën me

kanalin e ujërave të zeza që ndërtuan vetë, autori i kthyer para 1 jave nga Anglia nxorri armën

Report Tv ka zbardhur dinamikën e vrasjes së ndodhur në Laknas. 70-vjeçari Maliq Marku, me origjinë nga Dibra që ka qëlluar me armë dhe ka vrarë 55-vjeçarin Shefqet Hasa si dhe ka plagosur 50-vjeçarin Besim Keqa, ishte kthyer një javë më parë nga jashtë shtetit.

Disa kohë më parë, vetë banorët e rrugës kanë mbledhur para për ndërtimin e kanalit të ujërave të zeza, por Maliq Marku nuk ka paguar ngaqë ka qenë jashtë dhe nuk i është dashur. Pas kthimit nga Anglia, ka shkuar tek ujësjellësi për të lidhur edhe banesën e tij me kanalin. Ujësjellësi ka bërë piketimin, ndërsa 2 fqinjët sot i kanë thënë që nuk do ta ndërtonte. Në gjaknxehtësi e sipër 70 vjeçari ka marrë pistoletën dhe ka qëlluar drejt fqinjëve duke lënë të vdekur në vend njërin prej tyre me katër plumba.

B.K/Shqiptarja.com

Share

Ora 16:34

Kamëz/ U vra pas sherrit për kanalizimin e ujërave të zeza, viktima ndërroi jetë në derë të autorit (Video)

Kamëz- Report Tv ka shkuar pranë vendit të ngjarjes në Laknas ku mbeti i vrarë 55 vjeçari Shefqet Hasa, nga fqinji i tij 70-vjeç pas sherrit të ndodhur për kanalizimin e ujërave të zeza. Gazetari i Report Tv Sokol Dema raporton se pasi u qëllua me pistoletë pa leje nga 70 vjeçari viktima ndërroi jetë në derë të shtëpisë së autorit.

B.K/Shqiptarja.com

Share

Ora 16:16

Kamëz/ U vra nga fqinji pas sherrit për kanalizimin e ujërave të zeza, del fotoja e viktimës në Laknas

Ky është 55 vjeçari Shefqet Hasa që u vra me pistoletë në Laknas nga fqinji 70 vjeçar Maliq Marku pas një sherri që nisi për kanalizimin e ujërave të zeza.

B.K/Shqiptarja.com

Share

Ora 16:02

Tiranë/ Vrau fqinjin, autori u arrestua në banesë! Shefi i komisariatit: Shkak kanalizimi i ujërave të zeza, armën e kishte pa leje

Shefi i komisariatit numër.5 Oliger Torba, ka dhënë detaje mbi vrasjen e ndodhur sot në Laknas ku mbeti viktimë Shefqet Hasa. Ai thotë se autori është arrestuar në banesë ndërsa shkak i sherrit që çoi deri në vrasje ka qenë një kanalizim i ujërave të zeza. Besim Keça i cili mbeti i plagosur ndodhet në spital jashtë rrezikut për jetën.

> *"Autori i ngjarjes Maliq Marku u arrestua në banesën e tij si dhe është bërë dokumentimi i të gjithë ngjarjes. Rezulton që janë dy të dëmtuar. Shefqet Hasa që ka ndërruar jetë dhe Besim Keça që ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Nuk kanë pasur konflikte të mëparshme. Çiften e kishte pa leje, u kap nga shërbimet e policisë në banesë. Shkak për sherrin bëhet fjalë për një kanalizim të ujërave të zeza", tha Torba.*

B.K/Shqiptarja.com

Share

Ora 15:54

Vrasja në Kamëz, autori me dy fqinjët ishin konfliktuar edhe më parë! Shkak një kanal në afërsi të banesave

Report Tv zbardh detaje të tjera nga vrasja e 55 vjeçarit dhe plagosja e një tjetri nga fqinji 70 vjeçar në Laknas të Kamzës. Gazetari Sokol Dema nga vendngjarja raporton se shkak është bërë një kanal në afërsi të banesave. Për këtë çështje tre fqinjët janë konfliktuar edhe më parë, por sot fatkeqësisht sherri agravoi dhe 70 vjeçari Maliq Marku u fut në shtëpi mori armën dhe qëlloi në drejtim të Besim Keçës dhe Shefqet Hasës i cili mbeti i vdekur në vend.

B.K/Shqiptarja.com

Share

Ora 15:37

70 vjeçari vrau fqinjin me pistoletë për çështje pronash, pamjet e para nga vendi ku ndodhi krimi në Tiranë

70 vjeçari i cili u arrestua si autori i vrasjes së Shefqet Hasës dhe plagosjes së Besim Keçës, pasditen e sotme në Laknas të Tiranës, e ka kryer krimin me një pistoletë.

Policia informoi se Maliq Marku u arrestua në flagrance ndërsa i është sekuestruar dhe pistoleta arma e përdorur gjatë krimit.

Report Tv dhe shqiptarja.com sjell dhe pamjet e para nga vendi ku ndodhi vrasja.

S.G/Shqiptarja.com

Share

Ora 15:04

Vrasja në Laknas të Tiranës, ja çfarë thotë policia

Një ngjarje e rëndë është shënuar në Laknas të Tiranës. Nga të dhënat e para flitet për një person të vrarë dhe një të plagosur.

Kamëz/Informacion paraprak

Më datë 30.11.2023, në Laknas, në rrugën "Fatos Shupi", pas një konflikti për motive të dobëta, shtetasi M. M., rreth 70 vjeç, ka vrarë me armë zjarri shtetasin Sh. H., rreth 55 vjeç, si dhe ka plagosur shtetasin B. K., rreth 50 vjeç.

Shtetasi B. K., ndodhet në spital nën kujdesin e mjekëve.

Autori i dyshuar është arrestuar në flagrancë, si dhe është sekuestruar dhe arma e përdorur gjatë krimit.

Grupi hetimor po punon për sqarimin e rrethanave të ngjarjes.

S.G/Shqiptarja.com

Share

S.G/r.k./Shqiptarja.com

TAG: besim keça | Laknas | Tirane | kamez | Shefqet Hasa | Maliq Marku

Komento

Komente

Ndergjegja: 30/11/2023 19:53

Edhe kjo kronikë e zezë flet per përmasat e medha që ka marre përkeqsimi i SHENDETIT MENDOR NE POPULLSINE SHQIPTARE. Perkeqsimi i vazhdueshem i shendetit mendor eshte produkt i anarshise shteterore 30 vjeçare,i megakorrupsionit shteteror 30 vjeçar,i ndertimit te struktures hibride te sistemit social-ekonomik nga klasa e degjeneruar politike 30 vjeçare,i struktures mediatike false e ne sherbim te krimit e te korrupsionit shteteror....

Përgjigju

krimi rutine: 30/11/2023 19:24

Krimi eshte i njohur ne zonat informale, u kërkon ujesjellsi kontrata dhe nuk u ben kanalizimet,te prirur jane dibranët(gollot) per krim, sot,e 15 vjet me pare mos te kishim hapur rruge ne,na prene ujin e pijshëm afer shtepise,dhe u detyruam te benim lidhje me vete 200 m larg. Kush i pruri keta fshatare ne kryeqytet qe zbriten nga malet me shpata e lopata mos befte hajer ne kete bote.

Përgjigju

Bathorizimi i Berishës: 30/11/2023 18:59

Epo,ja shikojini me sytë tuaja pasojat e politikës liberale të Berishës: "lëvizje e lirë, votë e lirë". Mallkuar qoftë Berisha dhe Berishizmi!

Përgjigju

liri: 30/11/2023 18:08

u bene pronare maloket e dibres me tirane..nu vrafsjin me buke ne goje ishallah...

Përgjigju

Luani: 30/11/2023 17:35

Kafshet e shpellave nuk behen asnjehere njerez. Per nji kanal qe nuk ka kontribuar do te beje lidhje...oh sa mir me qen shqiptar or hej Hajt gezuar festat 2 dite e vrituni per 300 ditet e tjera. U hap nje hasmeri tjeter

Përgjigju

Seldi: 30/11/2023 17:29

Kur nuk funksiono as drejtesia as policia asnje pjese e shtetit nuk u ngelet gje tjeter Shqipove vetem te vriten me nj-tj. Shtet drogagji.

Përgjigju

albi: 30/11/2023 17:10

dhe ja albot qe nuk zhgenjejne kurre, po vazhdojne te vrasin njeri tjetrin per te njejtat arsye, si ne shekullin XI, edhe ne shekullin XXI. Popull trim e liridashes...

Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës:
Jeni dakord me nismën e Kishës Katolike për ndalimin e simboleve komuniste?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Makina gjermane e vitit vjen në Shqipëri! Cilët janë VIP-at që e testuan?

30 Nëntor, 16:01

'33 vite pa u dënuar me ligj krimet e komunizmit' Besim Ndregjoni: Çështja së shpejti në kongresin amerikan! Duam murin e kujtesës para Piramidës

30 Nëntor, 14:31



VIDEO/ 'Nata e Bardhë' 'elektrizoi' sheshin 'Skëndërbej', shqiptarët festojnë me yjet e muzikës

Ledina Jakimi

30 Nëntor, 10:55

Ilir Daja rikthehet në Tiranë para CL: Ballkani me mungesa, kemi nevojë për tifozët nga Shqipëria

29 Nëntor, 16:25

Këngë, valle e kostume, Shqiptaria bashkë në Teatrin e Operas! Historia rrëfehet me art! Nga 'Qëndistarja' te 'Cili je ti more burrë', Pavarësia e ritreguar

Anila Dedaj

29 Nëntor, 15:44

Nga Mc Cresha, Capital T, Ylli Limani te Luiz Ejlli, surprizat e koncertit të Natës së Bardhë sonte

29 Nëntor, 14:20

Favore seksuale në këmbim të tenderit për qentë, Gjykata e Lartë rrëzon Alma Kaçin

29 Nëntor, 11:24

'Duart lart se ju vramë', flet për Report Tv pronarja e argjendarisë në Kamëz: Morën 1.5 kg flori! 3 prej tyre u futën brenda, shoferi i priti te BMW

Sokol Dema

Freard Rista

29 Nëntor, 11:11

VIDEO/ Vetëm tre raunde, Arjon Kajoshi hedh 'K.O' boksierin kolumbian

28 Nëntor, 19:20

Grabitet argjendaria në Kamëz, 3 autorët të maskuar marrin 500 gram flori nën kërcënimin e automatikut! Momenti kur arratisen me 'BMW' (FOTO)

28 Nëntor, 17:47

Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës vishet kuq e zi për 111 vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë

28 Nëntor, 16:02



Lear Kurti vdiq nga mbidoza pas arrestimit, Prokuroria e Tiranës nuk gjen shkelje nga efektivët, kërkon në gjykatë pushimin e çështjes

Keti Banushi

28 Nëntor, 12:41

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje